

№. Prot 684

Dt: 25.03.2022



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË



**MINISTERO DELLA GIUSTIZIA**  
**ISPETTORATO GENERALE**

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

ndërmjet

Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë

dhe

**Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë delegon si përfaqësues të saj Drejtuesin e Inspektoratit të Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Italisë**

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur METANI dhe Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë e përfaqësuar nga Drejtuesja e Inspektoratit të Përgjithshëm, Dr. Maria Rosaria COVELLI, (këtu e mëposhtë referuar si "palët"),

- Në respektim të misionit, vlerave dhe parimeve që udhëheqin veprimtarinë institucionale të secilës palë;
- Duke marrë në konsideratë se në fushën e marrëdhënieve dypalëshe ekziston një interes i përbashkët, për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, të drejtës për një proces të rregullt ligjor si dhe mbrojtjen e interesit publik;
- Duke u mbështetur në faktin se, procesi disiplinor dhe inspektimi i sistemit të drejtësisë përbën një nga mekanizmat balancues për të siguruar që sjellja e magjistratëve të zhvillohet në bazë të parimeve pavarësisë, të ligjshmërisë, paanësisë, duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.
- Me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh në shkëmbimin e praktikave gjatë procedurave disiplinore, inspektimeve dhe në çështjet e interesit të përbashkët;

**Kanë rënë dakord si më poshtë:**

**Neni 1**

Qëllimi

Palët bien dakord që të fuqizojnë marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe të shkëmbejnë praktikat më të mira, në kuadër të realizimit të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve.

**Neni 2**

Objektivat

Për qëllime të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim "Memorandumi"), Palët do të bashkëpunojnë në mënyrat e mëposhtme:

- duke shkëmbyer informacion, praktika dhe përvoja që lidhen me realizimin e procedurave të hetimit administrativ disiplinor të magjistratëve, si dhe inspektimeve institucionale dhe tematike.
- duke dhënë këshillim mbi praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e kryerjes së inspektimeve dhe procedurave disiplinore ndaj magjistratëve;
- duke shkëmbyer përvoja mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve tematike dhe institucionale, përgatitjes së planeve vjetore të inspektimit si dhe rekomadime të natyrës legjislative, organizative apo funksionale për përmirësimin e funksionimit të gjykatave dhe prokurorive;
- duke shkëmbyer përvoja mbi mënyrën e komunikimit me publikun me qëllim sigurimin e ekuilibrit ndërmjet parimit të drejtësisë së hapur dhe respektimit të parimit të konfidencialitetit dhe të dhënave personale;
- duke shkëmbyer informacione për sistemin ligjor, legjislacionin në fushën e procedurave disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe materiale analitike, statistika apo raporte të inspektimeve;
- nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe atyre të punës, takimeve në çështjet e interesit të përbashkët ose veprimtarive të përbashkëta trajnuese si dhe duke zhvilluar seminare apo konferenca të përbashkëta për çështje të rëndësishme në fushën e veprimtarisë inspektuese.

### **Neni 3**

#### Koordinimi ndërmjet palëve

1. Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas këtij Memorandumi, palët përcaktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet realizohen ndërmjet tyre, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe.
2. Personat e kontaktit informojnë në vazhdimësi palët, në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi.
3. Komunikimi do të realizohet në formë shkresore ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në adresat e mëposhtme:
  - **Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë:**  
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë, Shqipëri  
E-mail: isida.koka@ild.al
  - **Inspektoriati i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Italisë:**  
Adresa: Via Silvestri n. 243, 00164, Roma, Italia  
E-mail: segr.capo.ispettorato@giustizia.it

### **Neni 4**

#### Shpenzimet

Veprimtaritë e parashikuara nga ky Memorandum do të zbatohen nga palët brenda kufijve të burimeve të tyre financiare, pa krijuar tarifa shtesë në lidhje me buxhetet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë dhe i Republikës së Italisë.

### **Neni 5**

#### Mbrojtja e të dhënave personale

1. Secila Palë do të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale të marra nga pala tjetër për kryerjen e aktiviteteve të bashkëpunimit dhe trajnimit të parashikuara në këtë memorandum, duke marrë përsipër të mos i transferojë ato te palët e treta dhe, në asnjë



rast, të mos i trajtojë ato në një mënyrë e papajtueshme me qëllimet e rëna dakord, pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

2. Çdo shkëmbim informacioni që rezulton nga zbatimi i këtij Memorandumi do të bëhet në mënyrë anonime dhe pa transmetimin e të dhënave personale që gjenden në dosjet e inspektimit.

### **Neni 6**

#### **Legjislacioni**

Ky Memorandum do të zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe italian, si dhe të drejtën ndërkombëtare në fuqi dhe, për sa i përket pjesës italiane, me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Italisë në Bashkimin Evropian.

Ky Memorandum nuk përbën një marrëveshje ndërkombëtare nga e cila mund të lindin të drejta dhe detyrime sipas së drejtës ndërkombëtare. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk do të interpretohet dhe zbatohet si një detyrim ose angazhim ligjërishit i detyrueshëm për Palët.

### **Neni 7**

#### **Efektiviteti, përfundimi, modifikimet dhe divergjencat**

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar kohe.
2. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Memorandum duke ia njoftuar qëllimin e saj Palës tjetër me njoftim tre muaj më parë.
3. Palët mund ta modifikojnë këtë memorandum me shkrim me marrëveshje reciproke.
4. Çdo mospërputhje në interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

Nënshkruar në *Roma* ..... me datë *24/03/22* ..... në dy kopje origjinale, secili në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të ndonjë dallimi, teksti në anglisht mbizotëron.

**Artur Metani**

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë i  
Republikës së Shqipërisë**



**Maria Rosaria Covelli**

**Drejtuese e Inspektoratit të  
Përgjithshëm deleguar nga Ministria  
e Drejtësisë e Republikës së Italisë**

